

**STABILIZIM-ASOCIIMI
NDËRMJET
BASHKIMIT EVROPIAN
DHE SHQIPËRISË**

**Bruksel, 9 shkurt 2018
(OR. en)**

Këshilli i Stabilizim-Asociimit

UE-ALB 4951/18

AKTE LEGJISLATIVE DHE INSTRUMENTE TË TJERA

Lënda: VENDIMI I KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI për pjesëmarrjen e Shqipërisë me cilësinë e vëzhgueses në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 168/2007

VENDIM Nr.../2018

I KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI

i ...

për pjesëmarrjen e Shqipërisë me cilësinë e vëzhgueses në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrat e kësaj pjesëmarrjeje, në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 168/2007

KËSHILLI I STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre Anëtare, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër¹,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 168/2007 të datës 15 shkurt 2007 e cila krijon një Agjenci të Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore² dhe në veçanti nenin 28 të saj,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Këshilli Evropian i Luksemburgut i muajit dhjetor 1997 e ktheu pjesëmarrjen në agjencitë e Bashkimit Evropian një mënyrë për përmirësimin e strategjisë së para-anëtarësimit. Konkluzionet e këtij Këshilli Evropian përcaktojnë se agjencitë e Bashkimit Evropian në të cilat do të mund të marrin pjesë vendet kërkuese, do të përcaktohen rast pas rasti'.
- (2) Shqipëria ndan qëllimet dhe objektivat e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ('Agjencia') dhe pranon objektin dhe përshkrimin e detyrave të Agjencisë, siç parashikohet në Rregulloren (KE) Nr. 168/2007.

¹ FZ L 107, 28.4.2009, fq. 166.

² FZ L 53, 22.2.2007, fq. 1.

- (3) Është e përshtatshme që Agjencia të trajtojë çështjet e të drejtave themelore brenda objektit të nenit 3(1) të Rregullores (KE) Nr. 168/2007 në Shqipëri në masën e nevojshme për harmonizimin e saj gradual me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
- (4) Si rrjedhojë, Shqipëria duhet të lejohet të marrë pjesë si vëzhguese në punën e Agjencisë dhe duhet të përcaktohen mënyrat e një pjesëmarrjeje të tillë, duke përfshirë dispozitat përpjesë marrjen në nismat e ndërmarra nga Agjencia, për kontributin financiar dhe për personelin.
- (5) Në përputhje me pikën (a) të nenit 12(2) dhe pikën (a) të nenit 82(3) të Kushteve të Punësimit të Nëpunësve të Tjerë të Bashkimit Evropian, të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit (KEE, Euratom, ECSC) Nr. 259/68¹, Drejtori i Agjencisë, me përjashtim, mund të autorizojë angazhimin e shtetasve të Shqipërisë që gëzojnë të drejtat e tyre të plota si qytetarë,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shqipëria, si vend kandidat, merr pjesë me cilësinë e vëzhgueses në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, të krijuar me Rregulloren (KE) Nr. 168/2007.

Neni 2

1. Agjencia mund të trajtojë çështjet e të drejtave themelore brenda objektit të nenit 3 (1) të Rregullores (KE) Nr. 168/2007 në Shqipëri në masën e nevojshme për harmonizimin e saj gradual me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Për këtë qëllim, Agjencia mund të kryejë në Shqipëri detyrat e përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të Rregullores (KE) Nr. 168/2007.

¹ FZ L 56, 4.3.1968, fq. 1.

Neni 3

Shqipëria kontribuon financiarisht ndaj aktiviteteve të Agjencisë të përmendura në nenin 4 të Rregullores (KE) Nr. 168/2007 në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 4

1. Shqipëria cakton persona të cilët përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 12(1) të Rregullores (KE) Nr. 168/2007 përkatësisht si vëzhgues dhe vëzhgues zëvendës . Ata mund të marrin pjesë në punimet e Bordit Drejtues mbi baza të barabarta me anëtarët dhe anëtarët zëvendës të emëruar nga Shtetet Anëtare, por pa të drejtë vote.
2. Shqipëria emëron një zyrtar qeveritar si Zyrtar Kombëtar Ndërlidhës i përmendur në nenin 8(1) të Rregullores (KE) Nr. 168/2007.
3. Brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi, Shqipëria informon Komisionin Evropian për emrat, kualifikimet dhe të dhënat e kontaktit të personave të përmendur në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 5

Të dhënat që i jepen Agjencisë ose që vijnë prej saj mund të botohen dhe të hapen për publikun, me kusht që informacionit konfidencial t'i jepet në Shqipëri i njëjti nivel mbrojtjeje që jepet në Bashkimin Evropian.

Neni 6

Agjencia gëzon në Shqipëri të njëjtin kapacitet juridik me atë të të personave juridikë sipas legjislacionit të Shqipërisë.

Neni 7

Me qëllim që t'i mundësojë Agjencisë dhe personelit të saj përmbushjen e detyrave të tyre, Shqipëria do të ofrojë privilegje dhe imunitete identike me ato të përcaktuara në nenet 1 deri 4, 5, 6, 10 deri 13, 15, 17 dhe 18 të Protokollit Nr. 7 mbi privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Evropian, bashkëlidhur Traktatit mbi Bashkimin Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Neni 8

Secila prej Palëve merr masa të përgjithshme ose specifike të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Vendimi dhe ia njofton Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së miratimit të tij.

Bërë në ...,

Për Këshillin e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri

Presidenti

SHTOJCË**KONTRIBUTI FINANCIAR I SHQIPËRISË NDAJ AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR TË DREJTAT THEMELORE**

1. Kontributi financiar që Shqipëria duhet t'i paguajë buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ('Agjencia'), siç përcaktohet në pikën 2, përbën koston e plotë të pjesëmarrjes së saj në të për tre vitet e para. Që nga viti i katërt, shumat do të përcaktohen në përputhje me pikën 6.
2. Kontributi financiar që Shqipëria duhet t'i paguajë buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian për tre vitet e para do të jetë si më poshtë:

Viti 1:	160 000 EURO
Viti 2:	163 000 EURO
Viti 3:	166 000 EURO

3. Mbështetja e mundshme financiare nga programet e asistencës së Bashkimit Evropian do të miratohen veçmas në përputhje me programin përkatës të Bashkimit Evropian.
4. Kontributi i Shqipërisë do të menaxhohet në përputhje me Rregulloren Financiare¹ të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit.
5. Kostot e udhëtimit dhe të jetesës të përballuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për pjesëmarrjen në punimet e Agjencisë ose në takimet që lidhen me zbatimin e programit të punës së Agjencisë duhet të rimbursohen nga Agjencia mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi si për Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.
6. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe në fillim të çdo viti pasues, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një thirrje për fonde që përkojnë me kontributin e saj ndaj Agjencisë sipas këtij Vendimi. Për vitin e parë kalendarik të pjesëmarrjes së saj, Shqipëria do të

¹ Rregullorja (BE, Euratom) Nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) Nr. 1605/2002 (FZ L 298, 26.10.2012, fq. 1).

paguajë një kontribut të llogaritur nga data e pjesëmarrjes deri në fund të vitit mbi bazë proporcionale. Për vitet në vijim, kontributi do të jetë në përputhje me tabelën sipas pikës 2 të kësaj Shtojce. Që nga viti i katërt, kontributi do të përshtatet duke pasur parasysh çdo rritje ose reduktim të subvencionit të Agjencisë për të ruajtur analogjinë midis kontributit për Shqipërinë dhe buxhetit të Agjencisë për BE-28. Kontributi mund të rishikohet gjithashtu edhe në vitet në vijim në bazë të të dhënave më të fundit statistikore të publikuara nga Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (Eurostat).

7. Ky kontribut shprehet në EURO dhe paguhet në një llogari bankare të Komisionit në EURO.
8. Shqipëria do të paguajë kontributin e vet sipas thirrjes për fonde për pjesën e saj brenda 30 ditëve pas dërgimit nga Komisioni të thirrjes për fonde.
9. . Në rast vonese në pagesën e kontributit, Shqipërisë i lind detyrimi për të paguar interesa mbi shumën e pashlyer duke filluar nga afati i fundit të kryerjes së pagesës. Norma e interesit i korrespondon normës së zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane në afatin e fundit të pagesës për veprimet e saj në Euro, e rritur me 1.5 pikë përqindjeje.